

Më datë 21-03-2013

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL, gjyqtari Adem Shabani, me asistentin Muedin Rexhepi, në çështjen penale kundër [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj, i akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.667-2/14 të dt 19.02.2015, sipas së cilës e ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nënpar.4 të KPRK-së duke vendosur rreth kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, më dt.22.06.2015 solli

AKTGJYKIM

APROVOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.667-2/14 të dt 19.02.2015, dhe gjykata jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj, i lindur me [REDAKTUAR] nga i ati [REDAKTUAR] e ëma [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë i gjendjes së varfër ekonomik, me numër personal të letërnjoftimit [REDAKTUAR], mbrohet në liri,

ËSHTË FAJTOR

Sepse me dt.08.06.2013 rrethë orës 20:25,min.në Ferizaj,në rrugën "Ahmet Kaçiku",përkatësisht në parkingun e [REDAKTUAR] pas një mosmarrëveshje të mëhershëm lidhur me me vrasjen e vëllaut të tij [REDAKTUAR] i pandehuri e godet të dëmtuarin [REDAKTUAR] i cili kishte qenë dëshmitarë në atë rast,me grushta në pjesë të ndryshme të trupit,me të cilin rast i dëmtuari kishte pësuar lëndime të të lehta trupore,ndrydhje e indeve të buta në regjionin përreth veshity,lëndime këto me pasoja të përkohshme për shëndet,-

- me të cilën kreu veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nënpar.4 të KPRK-së.

- Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 43, 46 dhe 73 të KPK-së dhe neneve 365 e 495 të KPPK-së i shqipton

DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarin [REDAKTUAR] i shqiptoi dënimin në shumën prej 200 € (dyqind Euro), të cilën shumë i akuzuari obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti do t'i shndërrohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet nga një (1) ditë burg.

Gjykata të dëmtuarin [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR], Komuna Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike i udhëzon në udhëzuar në kontest civil.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedural 20 Euro dhe paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.667-2/14 të dt 19.02.2015, ka akuzuar [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj, lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nënpar.4 të KPRK-së dhe të njëjtën ditë ka parashtruar kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor kundër të akuzuarit me arsyen se ka prova të besueshme që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i njëjti.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, në vështrim të nenit 414 par.1 të KPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor.

Nga provat materiale të bashkëngjitura në shkresat e lëndës gjyqtari ka lexuar ekspertizen e ekspertit mjeko ligjor i datës 01.01.2015, deklarata e të pandehurit e datës 20.02.2015 dhe 03.03.2014, deklarata e të dëmtuarit e datës 11.06.2013 si dhe shqimit të fotografive që gjinden në shkresat, ka konstatuar se këto prova janë të bazuara dhe bindëse, sepse vërtetojnë që i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së të dëmtuarin [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike është udhëzuar në kontest civil.


Konformë nennit 450 par.2.6 të KPPK-së obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguaj shumën prej 20 Euro, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ P.nr.243/2015 i dt.22.06.2015

Asistenti
Muedin Rexhepi

Gjyqtari
Adem Shabani



UDHËZIM JURIDIK:

Kudër këtij aktgjykimi lejohet kundërshtimi në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të dërgesës së njëjtit, gjyqtarit të vetëm gjykues të kësaj gjykate, përmes kësaj gjykate. Pas skadimit të afatit të lejuar për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor bëhet i plotëfuqishëm dhe ekzekutohet dënimi i shqiptuar.